



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 23 shtator 2016, në mbledhjen e XXXI-të
(tridhjetenjë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.10'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Kumrie Hoti, theksoi, në mbledhjen e mbajtur më 25 maj 2016, kam shtruar nevojën për përgatitjen e propozimit të vendimit për lirimin e nënave vetushqyese nga pagesa për fëmijët e tyre në çerdhen publike, meqë deri më tani nuk është përfillur kjo kërkesë, kërkoj që kjo çështje të përfshihet në rend dite.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, konsideroj se si çështje është në rregull të ngritët në mbledhjen e këtij Komiteti por edhe në mbledhje të Kuvendit, mirëpo për të debatuar është e nevojshme që paraprakisht Drejtoria kompetente të përgatitë propozimin me materialin përkatës.

Çështja e propozuar të shërbej si kërkesë e z. Kumrie Hotit për Drejtorinë kompetente e cila në një prej mbledhjeve të ardhshme do të përgatitë materialin përkatës.

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitet për Politikë dhe Financa më 28 korrik 2016

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Propozimi i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2017 dhe parashikimet për vitet 2018 – 2019

➤ Propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, duke u bazuar në projektet e parapara me këtë propozim të buxhetit, projekte të natyrave të ndryshme duke përfshirë edhe aspektin hapësinor të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë do ta ndihmojnë dhe lehtësojnë jetën e bashkëqytetarëve tanë, në Grupi i këshilltarëve i LDK – së e përkrahim propozimin e Vendimit për buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2017 dhe parashikimet për vitet 2018 – 2019.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, do të shtroj një kërkesë të banorëve të fshatrave Muhazob dhe Orllan, kërkesë e cila ndoshta ju është dorëzuar edhe gupeve tjera të këshilltarëve të përfaqësuar në Kuvend, lidhur me një rrugë e cila lidhë lagjet Deliu, Mani, Bucolli dhe Hashanëve që vazhdon për fshatin Metergoc. Një person i quajtur Shefqet Ahmeti i ka bërë disa investime në atë pjesë ku kishte mbjellë 4 hektarë mjedër por ishin të interesuar edhe për investime të tjera, mirëpo pengesë ishte rruga në gjendje shumë të keqe. Kërkesa e atyre banorëve është që në projeksionet e buxhetit për vitin 2017 të përfshihet edhe rruga e cekur në gjatësi afro 3 km.

z. Kadri Avdiu, theksoi, e kam lexuar materialin por mund të them se shumë pak kam kuptuar, po e përmendi rrugën Batllavë - Dyz për të cilën në vitin 2017 janë zero investime ashtu edhe në vitin 2018, ndërsa në vitin 2019 janë paraparë 90.000 €, rrugë e cila veç ka përfunduar.

I njëjti rast është edhe për rrugën Bellopojë – Tërnavë – Halabak.

Këtë vit materiali është hartuar ndryshe nga materialet e viteve të kaluara, ndoshta është bërë sipas udhëzimeve të Ministrisë përkatëse, por është hera e parë që dërgohet material i pakuptueshëm dhe i paqartë, së paku për mua.

z. Haki Rudari, theksoi, pajtohem me kolegun z. Kadri Avdiu ngase na është dërguar një material i pa detajuar dhe i pa specifikuar, nuk po e marrë se është bërë me qëllim mirëpo nëse i shikojmë projektet nuk dihet se cilit vit i referohen, me përjashtim të faqes së parë.

Sa i përket projekteve të parapara në këtë propozim buxhet, pajtohem me kolegët që debati të zhvillohet në mbledhje të Kuvendit, mirëpo e kam vërejtur se te Drejtoria e Arsimit ishin afro 140.000 € për investime kapitale, konsideroj se shuma e cekur nuk është e mjaftueshme bazuar në kërkesat e shumta të shkollave për infrastrukturë të ndryshme, andaj duhet shqyrtuar mundësitë për ngritjen e asaj shume.

Me një buxhet thuajse 19 milion, më shumë se 5 milion investime kapitale, jam i mendimit se do të ishte mirë që mjetet buxhetore përkatëse të shfrytëzohen për lëmi të ndryshme e jo vetëm për asfaltim e ujëra të zeza, i mbështes edhe projektet e këtilla, por konsideroj se Ekzekutivi i Komunës do duhej të orientohej edhe në çështje zhvillimore përkatësisht ngritjen e ndonjë fabrike, minifabrike apo të tjera.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, është hera e parë që propozimi i buxhetit është punuar me kode pesëvjeçare e kjo ka shkaktuar konfuzione, jo vetëm te këshilltarët e Kuvendit por edhe te ne, arsye

për të cilat kemi kërkuar sqarime.

Mendimi im është që për Kuvend, në mënyrë që të jetë e qartë për të gjithë, të përgatitet edhe forma e mëparshme, përkatësisht lista e veçantë e projekteve që është një model shumë më i thjesht dhe më praktik.

E përmenda se mënyra e këtillë paraqet konfuzione ngase ka, përsëritje të projekteve, ka projekte të para tri viteve me të njëjtin emërtim që punimet kanë përfunduar e shuma është zero, andaj për të identifikuar projektet në mënyrën e paraqitur në këtë material, kërkohet mund mjaftë i madh.

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, çështja e hemodializës, që u ngrit gjatë debatit, nuk planifikohet për tri vitet e ardhshme por në material është bartë vetëm si planifikime të viteve të mëparshme.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, edhe për mua fillimisht ky dokument ka qenë i paqartë, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave ishte në pushim vjetor andaj u drejtova në Shërbimin e buxhetit dhe pas konsultimeve u njoftova se materiali kësaj radhe ishte punuar për pesë vite dhe atë sipas një programi të Ministrisë së Financave. Përndryshe nëse e merrni dhe e krahasoni me Qarkoren Buxhetore janë të gjitha projektet përkatëse.

z. Isuf Latifi, theksoi, vitet e mëparshme, sigurisht jeni në dijeni, ju kam informuar se buxheti përgatitet për Ministrinë e Financave në dy sisteme dhe atë sistemet PIP dhe BDMS.

Sistemi PIP përfshin projekte që në material është lista e përgjithshme, ndërsa në Ministrinë e Financave dërgohen projektet me detaje dhe arsyeshmëri përkatëse.

Përndryshe programi i fundit është program të cilin e ka sponsorizuar Komisioni Evropian dhe është duke u implementuar hap pas hapi edhe në komuna.

Nëse jeni dakord, ne që sot mund t'ua dërgojmë listën e projekteve në excel, siç janë dërguar viteve të mëparshme, në mënyrë që të jenë të qarta projektet e propozuara prioritare.

Në vazhdim sqaroi mënyrën se si të identifikohen projektet për vitet përkatëse.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, do të ishte mirë që këshilltarëve, menjëherë pas kësaj mbledhjeje, t'ju dërgohet lista e projekteve prioritare në formën excel.

z. Kadri Avdiu, theksoi, pajtohem me sqarimet mjaftë të mira të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, mirëpo u dëshmuua se jo vetëm për mua por edhe siç e përmendi një drejtor, parafolës, mënyra e këtillë e paraqitjes të propozim buxhetit ka qenë e paqartëedhe për të, arsye për të cilën ka kërkuar konsultime me zyrtarë kompetent.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, sa i përket çështjes të cilën e shtroi z. Rafet Llapashtica, jam i mendimit se në kuadër të mjeteve të parapara për shtruarjen me zhavorr të rrugëve rurale do duhej t'i jepet prioritet rrugës së asaj treve.

z. Kadri Avdiu, theksoi, sa i përket rrugës për të cilën po debatohet u tha se në atë trevë jetojnë pak familje, mirëpo kohëve të fundit janë bërë investime në bujqësi, andaj jam i mendimit se nëse rregullohet ajo rrugë ndonjë familje sigurisht do të kthehet me jetuar atje, e kjo na obligon që ne të angazhohemi për krijimin e kushteve më të nevojshme që njerëzit t'i kthejmë në fshatra e jo me mos krijimin e kushteve infrastrukturore të ndikojmë në shpërnguljen e tyre.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, rruga në trevën e cekur është mëse e domosdoshme nëse mendojmë për krijimin e kushteve për zhvillimin e bujqësisë e cila bëhet në fshatra e jo në qytet. Ne këshilltarët duhet të japim ndihmën dhe kontributin tonë për projektet e vetëpunësimit duke u nisë nga fakti se Komuna nuk ka mundësi të krijoj vende pune në prodhimtari. Në rastin konkret investitori i cili në atë mjedis i ka mbjellë katër hektar mjedra sigurisht për vjeljen e tyre i punëson së paku 10 punëtorë sezonal, andaj nuk them që ajo rrugë në gjatësi afro 3 km. të shtrohet në asfalt se është kosto e madhe, por së paku të bëhet një zgjerim dhe të shtrohet ne zhavorr në mënyrë që rruga të jetë e kalueshme.

z. Isuf Latifi, theksoi, pajtohem me arsyeshmërinë që e paraqiti parafolësi sa i përket rrugës për të cilën po debatohet dhe jam për atë që të ndihmohet çdo qytetarë kur janë mundësitë për t'i ndihmuar duke përfshirë edhe çështjen e biznesit, por jo edhe për disa çështje luksoze po e zëmë kur qytetari nuk jeton në fshatin Muhazob e kërkon të asfaltohet rruga për në atë fshat.

Për ne ka qenë mjaftë e vështirë t'i zvogëlojmë subvencionet në bujqësi por kemi qenë të detyruar mbi bazën e Qarkores buxhetore II, edhe pse është një buxhet prej 303.000 € ngase dëshira e jonë ka qenë që subvencionet në bujqësi të jenë 480.000 €.

Sa i përket subvencioneve Komuna e Podujevës prinë në aspektin e lartësisë ngase subvencionet janë 2.95% të buxhetit total, ndërsa pason Komuna e Prishtinës me 2.93%.

Në vazhdim z. Isuf Latifi, e paraqiti fjalën hyrëse lidhur me propozimin e Rregullore së tatimit në pronë.

Pas votimit u konstatua se propozimi i Vendimit për Buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2017 dhe parashikimet për vitet 2018 – 201 dhe Propozimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2017, Kuvendit i rekomandohet njëzëri për shqyrtim.

4. Propozimi i Vendimit për lejimin e mjeteve buxhetore për realizimin në bashkëfinancim të projektit "Ngritja e përkujdesit shtëpiak dhe ambulantor (Home Care) në Komunën e Podujevës"

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalju, theksoi, jam i mendimit se propozimi i këtij Vendimi është mjaftë i qëlluar ngase një pjesë e qytetarëve kanë nevojë të madhe për shërbimet të cilat ofrohen për përkujdesje shtëpiake dhe ambulatore, pra e mbështes plotësisht mirëpo jam i interesuar të di se ky projekt a ka të bëjë vetëm për një pjesë të personave të cilët nuk mund të lëvizin apo për qytetarët të cilët nuk kanë mundësi të sigurojnë transportin.

z. Agron Hyseni, theksoi, sipas këtij projekti shërbimet përkatëse ofrohen në qytet dhe zona rurale për të gjithë qytetarët të cilët nuk kanë mundësi, qoftë për shkaqe të transportit apo shkaqe shëndetësore, që shërbimet t'i marrin në QKMF ose QMF, përndryshe kjo është një ambulante mobile e cila shërbimet i ofron në familje kudo çoftë që është e nevojshme.

z. Kumrie Hoti, theksoi, ne që punojmë në institucione shëndetësore i ofrojmë të gjitha shërbimet duke i përfshirë edhe shërbimet në familje, mirëpo pajtohemi se me këtë projekt krijohen mundësitë më të mëdha për ofrimin e këtyre shërbimeve shëndetësore.

z. Agron Hyseni, theksoi, jemi në dijeni se në institucionet aktuale ofrohen shërbimet shëndetësore përkatëse, por kur ju dilni në terren ambulanta mbetet me numër më të vogël të personelit shëndetësor, andaj me këtë projekt parashihet staf shtesë i cili nuk ka obligime ndaj QKMF – së përveç bashkëpunimit, pra ky staf shëndetësor gjithë kohën e punës është në gjendje mobile, kudo çoftë nevoja, duke përfshirë edhe sigurimin e medikamenteve të nevojshme.

Me këtë projekt stafit aktual shëndetësor do t'i lehtësohet puna e përditshme.

z. Kumrie Hoti, sa e kuptova për rastet e nevojshme ne mund të komunikojmë me QKMF – në dhe t'i informojmë për rastet në nevojë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

z. Agron Hyseni, theksoi, të gjitha rastet të cilat kërkojnë ndihmë prej stafit të QKMF – së e kanë mundësinë me marrë numrin e kontaktit të ambulantes mobile për të cilën qytetarët do t'i informojmë paraprakisht në mënyrë që këto shërbime të ofrohen në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, dhe në rastet kur të interesuarit nuk dinë ku të drejtohen, stafi mjekësor i adreson te shërbimi ambulantor përkatës.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, u përmend se sipas kostos financiare ky projekt do të jetë në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh dhe se nuk do të angazhohet personeli aktual shëndetësor, andaj jam i interesuar të di se personeli i cili do të rekrutohet për ofrimin e shërbimeve ambulantore, a do të jetë i Caritasit, Ministrisë së Shëndetësisë apo do të rekrutohet staf i veçantë.

Grupi i këshilltarëve i PDK – së e mbështet këtë propozim, jemi të mendimit se ky projekt është i vonuar dhe kemi kërkesë që pas kalimit të kësaj periudhe projekti të vazhdojë në kohëzgjatje prej një viti.

Gjithashtu, jemi të mendimit se është e nevojshme që përmes formave të ndryshme të bëhet informimi i të gjithë qytetarëve duke përfshirë edhe pjesët më të largëta rurale.

z. Haki Rudari, theksoi, në parim e mbështesim këtë propozim mirëpo nuk janë të qartësuara si do të rekrutohet stafi, ku do të jetë selia dhe kur do të fillojë zbatimi i këtij projekti ngase vetëm thuhet se ky projekt është në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh me mundësi vazhdimi. Përndryshe konsiderojmë se si ide është mjaftë e mirë ngase ka shumë familje që kanë nevojë për ofrimin e shërbimeve përkatëse shëndetësore.

z. Agron Hyseni, theksoi, e përmenda në fjalën hyrëse se stafi i cili do të punoj në këtë projekt do të jetë jashtë personelit aktual shëndetësor dhe se do të rekrutohet vetëm për shërbimin ambulantor. Sa i përket informimit për këtë projekt jemi të mendimit që këtë ta bëjmë me kosto minimale, për të mos thënë pa shpenzime dhe atë përmes kryetarëve të Komiteteve të fshatrave, QMF-ve, informimet në formë të shkruar dhe format elektronike. Sa i përket kohës së fillimit të zbatimit të këtij projekti, kjo është në proces dhe do të vazhdoj pas miratimit të këtij vendimi, kur do të nënshkruhet marrëveshja në të cilën do të specifikohen obligimet e palëve dhe të gjitha çështjet e nevojshme.

Selia për zbatimin e këtij projekti do të jetë në Podujevë.

z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, theksoi, Komuna në projektin për të cilin jemi duke debatuar participon me 17% të mjeteve, ndërsa përfitimet e qytetarëve do të jenë mjaftë të mëdha, andaj propozoj që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, njëzëri Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

5. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për fillimin e vitit të ri shkollor 2016 / 2017

z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, Informata është hartuar para afro një jave që do të thotë se i përmban të dhënat kryesore të nevojshme përveç rastit të SHFMU “ Enver Maloku “ ku kanë ndodhë disa lëvizje dhe nëse janë të interesuar anëtarët e këtij Komiteti, mund të jap informacione edhe për këtë çështje.

z. Fidan Rekalii, theksoi, duke u bazuar se në Informatë nuk është përfshirë çështja e SHFMU “ Enver Maloku “ jam i mendimit që fjala hyrëse të mos paraqitet në këtë mbledhje por ajo të paraqitet e plotë në mbledhjen e Kuvendit.

z. Kadri Avdiu, theksoi, një pjesë e konsiderueshme e nxënësve të cilët e kryejnë kl. IX të prej fshatit Penuhë e tutje drejtohen për regjistrim në Shkolla të Mesme të Larta në Prishtinë, mirëpo për fat të keq pavarësisht suksesit dhe rezultateve të testimit mjaftë të mirë nuk pranohet asnjë nxënës.

Tani është krijuar situata që një numër i nxënësve të shkëlqyeshëm kanë mbetur pa u regjistruar të cilët sikur të kishin aplikuar në Podujevë sigurisht që do të regjistroheshin në Gjimnaz ku kriteret janë më të larta, por tani nuk mund të regjistrohen as në Shkollën e Mesme të Lartë Ekonomike e as në Shkollën e Mesme të Lartë Teknike.

z. Haki Rudari, theksoi, lidhur me çështjen të cilën e ngriti parafolësi, sa unë jam në dijeni për drejtimet e Shkollave të Mesme të Larta të cilat janë në Podujevë, nuk lejohet regjistrimi i nxënësve të kësaj Komune në Prishtinë, këtë e them ngase personalisht e kam ngritur këtë çështje dhe jam informuar se vetëm për drejtimet të cilat nuk janë në Komunën e Podujevës lejohet konkurrimi dhe regjistrimi.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sa unë jam i informuar sipas Ligjit për Arsimimin Para Universitar, nxënësit të cilët nuk janë banorë të komunës përkatëse, në rastin konkret në Prishtinë në një periudhë të caktuar kohore nuk kanë të drejtë të regjistrohen në ndonjë Shkollë të Mesme të Lartë.

Në vazhdim shtoi, z. Fidan Rekalii, theksoi se nuk kemi nevojë për informacione por dihet se në Komunën tonë çështja e arsimit nuk është në gjendje të mirë, për këtë ne kemi debatuar disa herë, por edhe fillimi i vitit të ri shkollor nuk ka filluar për së mbari ngase një apo dy ditë më parë shkollat janë pajisur me ditarë e për këtë mund të fajësojmë këndo çoftë, por përgjegjësia bie në Drejtorinë e Arsimit e cila është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Po ashtu jemi në dijeni lidhur me pengesat për fillimin e mësimin në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “ Enver Maloku “ edhe për këtë Drejtorja e Arsimit e mbanë një pjesë të përgjegjësisë ngase është dashtë që gjatë kohës së pushimit të krijohen kushtet për vijimin e rregullt të mësimëve për nxënësit e asaj shkolle.

Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit e kam dëgjuar në një intervistë që ka thënë se jemi duke bërë përpjekje që së bashku me prindërit ta zgjidhim problemin, sipas mendimit tim nuk janë prindërit ata të cilët duhet të zgjidhin problemet në arsim, por kjo është përgjegjësi e Drejtorisë së Arsimit.

Gjithashtu është e nevojshme të jepen sqarime përse dhe si u hapen dyert e shkollës dhe si hynë mësimdhënësit me mbajt mësim në atë shkollë të papërfunduar, përkatësisht ky veprim a ka qenë i urdhëruar nga drejtori.

Në buxhetin e Komunës kemi pasë mjete të parapara për renovim të shkollave andaj ato mjete është dashtë të destinohen aty ku ka qenë nevoja më e madhe. Gjendja jo e mirë

e objektit të shkollës “Enver Maloku “ nuk është vetëm në këtë vit por mund të themi se gati e njëjta gjendje ka qenë edhe para tri viteve, kohë kur drejtori aktual i Drejtorisë së Arsimit ka qenë drejtor i asaj shkolle, mirëpo përkundër këtij fakti nuk është ndërmarrë asgjë për sigurimin e hapësirës ku do të mësonin nxënësit e asaj shkolle.

z. Fidan Rekalii, theksoi, pa dashje që të hyjë në debat me z. Rafet Llapashticën , por duke u bazuar në atë që e tha drejtori z. Avni Maloku se Informata është përgatitur para 7 apo 8 ditëve dhe se nuk janë përfshirë aktivitetet brenda kësaj kohe, unë thash se nuk ka nevojë të paraqitet fjala hyrëse me qëllimin që informacionet e plota të paraqiten në mbledhjen e Kuvendit.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, informata e cila na është dërguar për mua është dokument zyrtar në bazë të të cilës unë do të debatoj në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, ne jemi të detyruar që materialin e Kuvendit ta dërgojmë shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjeve, mirëpo pas dërgimit të materialit për këtë mbledhje ka pasë zhvillime të tjera të cilat nuk janë përfshirë në Informatë dhe drejtori z. Avni Maloku, shprehu gatishmërinë për të paraqitur informacione shtesë.

z. Avni Maloku, theksoi, z. Kadri Avdiu shtroi një çështje mjaftë të rëndësishme lidhur me problemin për regjistrimin e nxënësve të Komunës së Podujevës në Shkolla Fillore të Mesme të Larta në Prishtinë, lidhur me këtë kam biseduar në mënyrë kolegjiale me drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës e cila kishte informacione për mënyrën se si ligjërisht rregullohet ajo çështje, mirëpo de facto nuk është ashtu. Në vitin e kaluar nxënësve të Komunës së Podujevës nuk u është lejuar fare të hyjnë në konkurrencë në asnjë drejtim, ndërsa këtë vit i janë nënshtruar konkurrencës mirëpo nuk është përzgjedhë asnjë edhe pse ne kemi dëshmi kur një nxënës me të gjitha notat pesëshe dhe 89 poena që i bie 90% të rezultatit nuk është pranuar, ndërsa nëse shikohen listat e shkollave të Prishtinës janë pranuar nxënës me rezultate më të ulëta. Tek unë kanë ardhur 22 nxënës të cilët kanë konkurruar në Prishtinë me të gjitha notat pesëshe dhe mbi 72 poena dhe janë refuzuar për regjistrim, të cilët në Gjimnazin e Podujevës do të radhiteshin të parët.

Sa i përket përfundimit të punimeve në SHFMU “ Enver Maloku “ jemi në dijeni për zhagjitjet me vitet të tëra të punimeve në atë objekt ku edhe pas disa rishikimeve të kontratave punimet nuk kanë përfunduar ende ashtu siç nuk kanë përfunduar sipas rishikimit të fundit të kontratës që objekti do duhej të dorëzohej më 14 korrik 2016.

Do theksuar se 120 nxënës kanë mbetur jashtë Gjimnazit vetëm për arsye të mungesës së hapësirës në objekt, për këtë kam qenë në dijeni por unë kam menduar se më 15 korrik 2016 do të jetë i gatshëm objekti i ri shkollor e në këtë rast do të kishte hapësirë të nevojshme edhe për një numër të konsiderueshëm të nxënësve.

Me ndihmën e z. Agim Veliut, Kryetar i Komunës, kemi arritur të krijojmë kushtet për pranimin në Shkolla të Mesme edhe të 200 nxënësve duke përfshirë edhe ata të cilët nuk kanë mundur të regjistrohen në Prishtinë.

Lidhur me mos përfundimin e punimeve në objektin e SHFMU “ Enver Maloku “ që neve na ka krijuar probleme shumë të mëdha, unë shtroj pyetjen si mund të arsyetohet MASHT-ti që ky objekt nuk është përfunduar edhe pse kanë kaluar 8 vite prej se kanë filluar punimet.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, zotëri drejtor pyetja ime ishte konkrete, a ke urdhëruar që në objektin e SHFMU “ Enver Maloku “ nxënësit dhe profesorët të hynë në mënyrë të dhunshme.

z. Avni Maloku, vazhdoi, në Informatë është e shkruar në mënyrë të qartë se më 5 shtator 2016 SHFMU “ Enver Maloku “ nuk e ka filluar mësimin, ndërsa më 7 shtator 2016 unë së bashku me z. Nexhmi Rudarin, nënkryetar i Komunës dhe z. Alush Istogu, sekretar permanent i MASHT- it, kemi pasë një takim te objekti në të cilin janë duke u zhvilluar punimet dhe jemi dakorduar që të nesërmen, më 8 shtator, MASHT – i të shqyrtoj kërkesën e punë kryesit dhe në afatin sa më të shkurt ta informoj Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit se çfarë do të bëhet me atë objekt.

Fatkeqësisht më 14 shtator 2016 në bazë të kërkesës time jam informuar, përmes E-mail, it, se MASHT – i punë kryesit i është zgjatë afati deri më 1 nëntor 2016 me kusht që nëse nuk i përfundon punimet deri në atë afat, kontrata do t'i shkëputet në mënyrë të njëanshme.

Të njëjtën ditë e kam ftuar në takim Këshillin Drejtues të SHFMU “ Enver Maloku “ dhe ua kam lexuar E-mail, in përkatës, prindërit me këtë vendim nuk kanë qenë të kënaqur fare dhe të revoltuar më kanë thënë, drejtor nuk mund të jemi të kënaqur ngase qe tetë vite na gënjejnë.

Personalisht prindërit i kam lutur që të mos ndërmarret ndonjë veprim i njëanshëm në kuptimin Komunë apo Këshill Drejtues i Shkollës, por të zhvillohen sërish biseda me MASHT – in që të sqarohet një herë e përgjithmonë çështja e atij objekti dhe bashkërisht të marrim vendimin se çka do të bëjmë, ngase 900 nxënës nuk mundemi me i lënë në rrugë, por do t'i shqyrtojmë mundësitë tona se çfarë mund të bëjmë. Mirëpo fatkeqësisht prindërit që në këtë rast janë palë nuk e kanë pranuar këtë zgjidhje dhe të hënën janë futur në objekt me dhunë apo quajeni si të doni por kjo nuk ka qenë me lejen e Komunës.

Pas kësaj e kam ftuar Këshillin e prindërve për takim në Komunë, i janë përgjigj thirrjes dhe pas konsultimeve prindërit janë dakorduar që më nuk do të ndërmarrin veprime të njëanshme. Po të njëjtën ditë kam pasë takim me Këshillin e Arsimtarëve dhe ua kam komunikuar marrëveshjen me Këshillin e Prindërve. Së bashku me Këshillin e Arsimtarëve jemi marrë vesh që Drejtoria e Arsimit të bëjë zgjidhje të përkohshme.

Dje, me kërkesën time, e kam pasë një takim të serishëm në MASHT me tre këshilltarë të Ministrin z. Arsim Bajrami, të cilëve ua kam komunikuar atë çfarë kanë kërkuar prindërit që të na japin siguri se shkolla do të hapet në një periudhë sa më të shkurtë kohore e brenda kësaj kohe ne do të bëjmë zgjidhje të menjëhershme të kuptohemi të përkohshme për nxënësit e asaj shkolle.

Dihet se investitor i objektit shkollor përkatës është MASHT – i, gjatë debatit u përmend se unë kam qenë drejtor i shkollës “ Enver Maloku “, mirëpo sot e ndjej veten keq ngase sikur ta kisha ditur se punimet do të neglizhohen në këtë mënyrë, para katër viteve të gjithë prindërit i kisha ngritur në këmbë dhe me ju thënë, fare nuk do të punojmë derisa nuk na sqarohet përse nuk kryhen punimet e kontraktuara, këtë e them duke mos e ndërlidh në aspektin politik ngase në atë kohë nuk ka qenë Ministri aktual i MASHT it.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, këtu askush nuk është për të mbrojtur subjekte politike por programe të subjekteve politike qeverisëse gjithsesi, por jo individ të caktuar, së paku jam duke folur për konceptin tim. Në rastin konkret pyetja ime është, a ke qenë gjatë pushimit te shkolla përkatëse për me shikuar se a janë duke u zhvilluar punimet dhe a ke qenë ndonjëherë te Ministri për t'i thënë se me 1 shtator nxënësit nuk kanë ku t'i vijojnë mësimet.

z. Naim Çunaku, theksoi, nga fjala e z. Avni Malokut, drejtor i Drejtorisë së Arsimit doli, në pah se si në komunat tjera në Kosovë ashtu edhe në Komunën e Podujevës, fillimi i vitit shkollor ka filluar me probleme, mirëpo te ne po shihet se ka probleme të një natyre ku problemi kryesor është sigurimi i objekteve fizike, situatë ndaj të cilës nuk mund të jemi indiferentë, andaj apeloj që nëse nxënësve të cilët e kanë kryer arsimin e mesëm fillor nuk mund t'ju ofrojmë kushtet për me vazhduar shkollimin e tyre të mëtutjeshëm, nuk konsideroj se ky problem duhet të jetë vetëm i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit ngase fundja ky është problem i cili do duhej të na shqetësoj të gjithëve meqë ka të bëjë me fëmijët tanë dhe më së paku kisha dëshiruar që këtë ta fokusojmë në kahje politike, që e pranuar apo jo, kjo po reflektohet.

Drejtori z. Avni Maloku, tha se sipas legjislacionit në fuqi niveli lokal duhet t'i sigurojë kushtet për nxënës, ndërsa çështja e sigurimit të objekteve shkollore është në kompetencë të nivelit qendror.

Konsideroj se kompetenca e sigurimit të objekteve shkollore duhet t'i kthehet komunave ngase kur e kanë përgjegjësinë për krijimin e kushteve për vijimin e rregullt të procesit mësimor atëherë, përmes Kuvendit të Kosovës përkatësisht ndryshimeve ligjore, duhet t'ju delegohet edhe kompetenca për sigurimin e objekteve shkollore, pra kjo e drejtë të decentralizohet nga MASHT i në komuna, ngase përgjegjësitë e cekura nuk mund të jenë të ndara.

Krejtësisht në fund, për çështjen për të cilën jemi duke debatuar kisha dëshiruar që të angazhohemi të gjithë, e nëse është nevoja edhe të bëjmë kërkesë përmes Kuvendit të Komunës apo edhe të miratojmë vendim për krijimin e kushteve mobile për tejkalimin e situatës së krijuar për ata nxënës.

Gjithashtu u fol edhe për atë përse nxënësit e Komunës tonë nuk pranohen në Prishtinë, lidhur me këtë në mënyrën më të sigurtë e them se kjo që ka ndodhë dy vitet e fundit me Komunën e Prishtinës e cila ka krijuar barriera për nxënësit e Podujevës që të mos kenë mundësi të vazhdojnë shkollimin në Prishtinë është kundërligjore.

Sipas mendimit tim Ligji përkatës nuk e përcakton se një nxënës i cili e përfundon ciklin e shkollimit të mesëm të ulët ku do të vazhdoj ciklin e shkollimit të mesëm të lartë, pra kufizimi në këtë aspekt është kufizim i të drejtave individuale.

Pajtohem se sipas dispozitave ligjore parashihet shkolla më e përafërt por nuk përcaktohet komuna. Shembull mund të marrim se ne tradicionalisht prej fshatit Llužhan e tutje jemi orientuar në Prishtinë apo rasti tjetër përse një nxënës i fshatit Lupç i Poshtëm – Lagjja e Pirevëve të vijojë mësimet në Podujevë ku largësia është 18 km. ndërsa Prishtina është 9 km. , nga kjo brenga ime është përse diskriminohen në mënyrë kundërligjore që nxënësit në bazë të suksesit të arritur të vazhdojnë shkollimin aty ku ata dëshirojnë.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, e përgëzoi Drejtorinë e Arsimit që këtë Informatë e ka proceduar me kohë për shqyrtim përkundër angazhimeve, problemeve të përditshme dhe presioneve të kohëve të fundit. Është e pamundur të mos përmendet se prej vitit 2008 e deri në vitin 2016 nuk është nderuar objekti i shkollës përkatëse kur sipas kontratës punimet do duhej të përfundonin brenda dy viteve, mirëpo edhe pas vazhdimit të disahershëm të kontratës objekti nuk është përfunduar, fakt i cili ka shkaktuar probleme mjaftë të mëdha.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

6. Anulimi i:

-Vendimit nr.01-066-52462 dt. 29.06.2016 për inicimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të Futbollit "Llapi" në Podujevë me qëllim të themelimit të klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare, dhe

**-Vendimit nr.01-006-52807 dt.29.06.2016 për ngritjen e komisionit për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve të Klubit të Futbollit "Llapi" në Podujevë,
(Për arsye se MKRS e ka vlerësuar se Vendimet janë në kundërshtim me dispozitat ligjore)**

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

Nuk pati diskutime, ndërsa pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohen për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi në orën 14.40'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-72638
Podujevë,
23 shtator 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**